Nr prot 432
datë: 20.03.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DHOMA E TREGTISË
DHE INDUSTRISË TIRANË

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ndërmjet palëve:

DHOMËS SË TREGTISË DHE INDUSTRISË TIRANË, në vijim referuar si "DHOMË" veprimtaria e të cilës mbështetet në ligjin Nr. 9640 datë 9.11.2006 "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë" , me seli Rruga e Kavajës, Bld 2/2, 1001 Tiranë, përfaqësuar nga Z. Nikolin Jaka, Kryetar i DHOMËS

dhe

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE, në vijim referuar si "INSTAT", veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin Nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare", i ndryshuar, përfaqësuar nga Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT.

PALËT BIEN DAKORT:
Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

NENI 1
Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit

1. Kjo marrëveshje synon sigurimin e bashkëpunimit midis dy palëve nënshkruese lidhur me:

   a) Përmirësimin e cilësisë statistikore dhe rritjen e llojeve dhe përdorimit të produkteve statistikore për sipërmarrësit tregtarë dhe përdoruesit e tjerë;
   b) Përmirësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve të trajnimit me koncepte dhe analiza të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të sistemit statistikor në Shqipëri;
   c) Planifikimin e organizimin e veprimtarive të përbashkëta njohëse dhe promovuese

për të mundësuar njohjen e kuptimin sa më të mirë të statistikave nga sektori i biznesit dhe tregut në tërësi;

2. Palët angazhohen të punojnë së bashku në përputhje me kërkesat ligjore dhe frymën e mirëkuptimit, për të realizuar interesat reciproke që synon kjo marrëveshje.

NENI 2
Fushat e bashkëpunimit

Palët angazhohen për të bashkëpunuar për çështjet me interes të përbashkët, në këto drejtime:

a) Rishikimin në mënyrë të rregullt në drejtimin e bashkëpunimit në interes të shkëmbimit të informacionit;
b) Pjesëmarrjen në aktivitetet që organizohen nga palët respektive lidhur me projektet zhvillimore të cilat mund të ndikojnë në krijimin, zhvillimin dhe transmetimin e të dhënave të fushës ekonomike e tregtare;
c) Shkëmbimi i materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe kërkimore të lidhura me aktivitetin e DHOMËS dhe INSTAT në respekt të parimit të konfidencialitetit dhe mirëbesimit;
ç) Mbështetjen infrastrukturore që disponojnë palët për zhvillimin e trajnimeve në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe planifikimit/njoftimit paraprak.
d) Pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese që organizaojnë palët respektive për rritjen e kapaciteteve profesionale, fushën e veprimtarisë ekonomike e tregtare, zhvillimin e sistemeve IT për krijimin dhe administrimin e të dhënave, të cilat ndikojnë në cilësinë e prodhimit dhe zhvillimit statistikor;
dh) Angazhimin e palëve në projekte të perbashkëta kërkimore dhe studimore;
e) Mbështetjen nga INSTAT për shkëmbimin e informacionit, sipas kërkesës së DHOMËS, lidhur me materiale të ndryshme burimore, dokumente e të dhëna për treguesit ekonomikë sipas sektorëve potencialë, duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe politikave të aksesit të të dhënave mikro të INSTAT;
ë) Mbështetjen nga DHOMA për ofrimin në kohë dhe me cilësi të të dhënave që disponojnë shoqëritë tregtare anëtare të DHOMËS, të nevojshme për prodhimin cilësor të statistikave zyrtare;
f) Identifikimin dhe informimin e vazhdueshëm mbi mundësitë prodhuese në vend për importet, eksportet, shkëmbimet tregtare dhe bashkëpunimin ekonomik;
g) Mundësinë për kryerjen e kërkimeve dhe analizave mbi tregun dhe sipërmarrjen, duke respektuar standardet ligjore dhe brenda fushës së kompetencave të palëve.

NENI 3
Pronësia intelektuale

Kur si rezultat i bashkëveprimeve të kryera në përputhje me këtë memorandum, realizohen produkte që janë objekt i së drejtës mbi pronësinë intelektuale, ato do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 4
Komunikimi

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm në lidhje me fushën e veprimtarisë sipas këtij memorandumi. Me qëllim përmbushjen e objektivave të këtij memorandumi, secila palë do të caktojë një person kontakti për të koordinuar komunikimin dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit.

NENI 5
Kufizimet e memorandumit

1. Palët bien dakort që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të përparësive, planifikimit paraprak, burimeve dhe potencialit që disponon secila palë.
2. Për çdo veprimtari tjetër, e cila përputhet me frymën e këtij memorandumi, palët kanë të drejtë të konkludojnë mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit.
3. Ky memorandum mirëkuptimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.
4. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, palët do t'i rregullojnë këto raporte me marrëveshje të veçanta financiare të cilat do të jenë pjesë integrale e këtij memorandumi.
5. Palët bien dakort që të ruajnë dhe respektojnë integritetin reciprok.

NENI 6
Ndryshimi, amendimi dhe revokimi i memorandumit

Ky memorandum mund të ndryshohet ose revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet palëve.

NENI 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e këtij memorandumi, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve.

NENI 8
Hyrja në fuqi

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të palëve, dhe do t'i shtrijë efektet për një periudhë kohe të pakufizuar.
Ky memorandum hartohet në dy kopje dhe secila palë mban një kopje në origjinal.

Nënshkruar sot, më datë__/__/2018, në Tiranë

Për DHOMËN E TREGTISË DHE INDUSTRISË TIRANË
KRYETAR

NIKOLIN JAKA

Për INSTITUTIN E STATISTIKAVE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

DELINA IBRAHIMAJ